

URDHËR
Nr. 1, datë 6.1.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 22, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, datë 28.5.2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të kreut VII, të nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm z. Arian Kraja, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fondet buxhetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm, duke filluar nga data 6.1.2020 deri më 31.12.2020.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj